

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	100 apo 15 bashki? Demokratët e socialistët bëjnë lëvizjen e radhës, PD i dërgon draft ligjin Kuvendit, m azhoranca kërkon aprovimin e Peleshit
ADRESA	https://newsbomb.al/politike/100-apo-15-bashki-ne-vend-demokratet-e-socialistet-bejne-le-vizjen-e-rad-i402038
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 15:20:16 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 15:12:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	72dbcc6ffbf55ae095bc7cfff41d5583c8f7aec8b693f34a29a533ba98bdd3092
TEKSTI	20fd6f018a8fa1b4c042252bb601d20d6679839e492678ef0a40c5cec644a4f6
PAMJA	5e806482a131c1003f36b07dc5c0a2ca0aea0bab3ff733a1e9baac823ebc908f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e929b6bf3b3735ec40c349a88ab19f008381498104cba69a53efefa951ea7c8e
E MËPARSHMJA	6de31b4be39339e955ef408ad5f37494bae6f32e222eb08317f72d211b011b7c
RRËNJJA MERKLE	77d68db3023b2e51e8611bf6d5eddb24bf36cfc38da7912fff4d1353a313a25f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/e929b6bf3b3735ec40c349a88ab19f008381498104cba69a53efefa951ea7c8e

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë & Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



Çështjet kryesore

SPAK në gjurmët e shtetarëve të lidhur me Agasin

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

Politikë

25 Shtator 2026, 17:12

100 apo 15 bashki? Demokratët e socialistët bëjnë lëvizjen e radhës, PD i dërgon draft ligjin Kuvendit, mazhoranca kërkon aprovimin e Peleshit



Shkruar nga Newsbomb



Ilustrim

Ditën e sotme Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka depozituar në Kuvend ligjin për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Shqipëri, nga ku mësohet se kanë propozuar që vendi të ketë në total 100 bashki dhe 12 qarqe.

Përgjatë propozimit të tyre, demokratët sqarojnë se ata nuk duan që të shtojnë numrin e bashkive për të rritur më shumë endet e punës, por me idenë që vendi të ketë më shumë zyra dhe të funksionojë më shumë si një vend demokratik. Ndërsa shtojnë se ky propozim për pothuajse dyfishimin e bashkive në vend bëhet në të mirën e qytetarit dhe të zhvillimit të territorit.

"Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike nuk e konsideron Reformën Administrativo-Territoriale një betejë për numrin e bashkive. Çështja themelore është modeli i pushtetit vendor që Shqipëria dëshiron të ndërtojë. Ne nuk propozojmë më shumë bashki për të krijuar më shumë poste. Propozojmë bashki funksionale aty ku ato janë të nevojshme për të krijuar: më shumë afërsi, më shumë demokraci, më shumë përgjegjshmëri, më shumë shërbime, më shumë autonomi dhe më shumë zhvillim.

Nuk propozojmë 12 Qarqet për të krijuar një nivel burokracie. Propozojmë struktura që të krijojnë: zhvillim, koordinim, investime dhe mundësi të reja për territorin. Mbi të gjitha, nuk propozojmë një hartë që i shërben administrimit të pushtetit. Propozojmë një hartë që i shërben avtetarit, komunitetit dhe zhvillimit të territorit" shkruhet në draft ligjin e

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Aktualitet

Dy ditë pas bashkëpunëtorit të tij, PRANGOSET në Dubai trafikanti shqiptar Eldi Dizdari, pritet të përballlet me drejtësinë belge (DETAJE)



Aktualitet

Vuno shpallet "Qendër Historike", Qeveria miraton zonën e mbrojtur dhe planin e administrimit

Zbulu më shumë artikuj >

depozituar nga ana e demokratëve në Kuvend.

Në përmbllje të draft ligjit të tyre, nga ana e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike shkruhet: **Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike propozon: 100 BASHKI + 12 QARQET të mbështetura nga: Decentralizim Real; Autonomi Financiare; Kompetenca të Qarta; Përgjegjësi dhe Llogaridhënie; Demokraci Lokale; dhe Zhvillim të Balancuar Territorial.**

Nga ana tjetër mësohet se dhe mazhoranca ka kërkuar nga ana e Kuvendit mendimin e saj për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë. Nëpërmjet një njoftimi të ndarë nga Agjencia për Media dhe Informim mësohet se Këshilli i Ministrave ka miratuar disa vendime, në mesin e të cilave renditet dhe: **Dhënia e mendimit Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për projektligjin joqeveritar "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".**

Kujtojmë se mazhoranca ka propozuar shkrirjen e 61 bashkive në 46 të tilla, ndërsa opozita ka propozuar thuhje dyfishim të tyre me synim për të pasur në rang vendi 100 bashki dhe 12 qarqe.

Njoftimi i plotë:

Agjencia për Media dhe Informim ju bën me dije vendimet e miratuara në mbledhjen e sotme të qeverisë datë 25.09.2026.

Këshilli i Ministrave miratoi vendimet për:

-Deklarimin Pasuri Kulturore e Paluajtshme "Qendër Historike" të fshatit Vuno, përcaktimin e zonës mbrojtëse dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre.

-Miratimin, në parim, të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, në cilësinë e financuesit, dhe Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP)

-Dhënien e mendimit Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për projektligjin joqeveritar "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"

-Rishpërndarje fondesh në buxhetin e miratuar për vitin 2026, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Inspektoratit të Përgjithshëm.

-Propozimin e projektligjit "Për pranimin e ndryshimeve të përshtatura më 30 maj 2025 të memorandumit të mirëkuptimit të Parisit për Kontrollin Shtetëror portual, bërë në Paris, më 26.1.1982, aderuar me ligjin nr.9852, datë 26.12.2007".

Njëherësh u miratuan edhe disa emërime dhe shkarkime të drejtuesve të institucioneve

-Z. Emiliano Gjika, kryetar i Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve, lirohet nga kjo detyrë.

-Znj. Ina Zeqaj emërohet kryetar i Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve.

-Z. Oltjon Muzaka, zëvendësministër i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, lirohet nga kjo detyrë dhe emërohet zëvendësministër i Punëve të Brendshme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ✓

Nr. 4329 Prot.

Tiranë, më 25.09.2026

Lënda: Propozohet për shqyrtim dhe miratim një projektligji.

Drejtuar: Z. Niko PELESHI
Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë

Z. Kryetar i Kuvendit,

Në mbështetje të nenit 81, pika 1 të Kushtetutës dhe nenit 68, pika 1 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, bashkëlidhur gjeni për shqyrtim dhe miratim projektligjin "Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njërive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë", shoqëruar me relacionin përkatës, të propozuar nga një grup deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

Në përputhje me nenin 82, pika 2, nenin 108, pika 2, të Kushtetutës së Shqipërisë, dhe nenin 90 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, projektligji, së bashku me relacionin shoqëruar duhet t'i dërgohet për mendim zyrtar:

1. Këshillave bashkiakë të 61 bashkive;
2. Këshillave të qarqeve të 12 qarqeve;
3. Këshillit të Ministrave;
4. Kontrollit të Lartë të Shtetit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komitetit të Pakicave Kombëtare dhe Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Organet e sipërmendura japin mendimin brenda 60 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për shprehje mendimi nga ana e propozuesit. Mendimi i tyre institucional është paraprirë nga ana jonë me konsultimet me komunitetet dhe marrjen në konsideratë të mendimit të tyre.

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu



🕒 E Premte 16:13

Edi Rama nga New York: Joe Biden e tradhtoi Hashim Thaçin, SHBA nuk bëri më të mirën për të



Politikë

Këshilli i Ministrave firmos ndryshime në drejtimin e institucioneve, ja emërimet dhe lirimet nga detyra (EMRAT)

🕒 E Premte 16:02



Politikë

Qëlloi me lugë e shishe të rinjtë protestues, reagon Delina Fico: Po haja qofte dhe po pija birra, s'përmbajta veten kur i përmendën Bledit "gruan"

🕒 E Premte 14:44





E Premte 14:19

Këshilli Bashkiak i Tiranës me letër SPAK-ut dhe Burgjeve, kërkon që Erion Veliaj të dalë nga burgu: Na i sillni kryebashkiakun, është e nevojshme



Politikë

Anulohet tenderi 4.59 miliardë lekë për hemodializën në pesë qytete, Agjencia e Prokurimit Publik: Kishte mangësi dhe gabime në dokumente

E Premte 13:23



Politikë

"Vendi ka pësuar dëme të pallogaritshme", ish-ministri Sandër Lleshaj thirrje politikës të marrë masa: Gjëmë e padëgjuar kurrë, qytetarët nuk kanë kujt t'i besojnë më

E Premte 08:36

Politikë **oni i Punës**

Pozicioni i Punës	Paga e pozicionit në lekë
Kryetari.....	246 000 lekë
Nënkryetari.....	189 625 lekë
Administratori i njësish me.....	148 625 lekë
Administratori i njësish me.....	143 000 lekë

b-kufijt e pagave sipas pikes I.2.d; (ja nr.6)

Pozicioni i Punës

Pozicioni i Punës	Paga e pozicionit në lekë
Sekretar/sekretar.....	144 525
Sekretar.....	75 000
Keshill.....	109 000

E Enjte 23:19

Fenomeni i gjyqtarëve "infekton" dhe kryebashkiakët, demokrati i Mirditës kërkon rrogë 2.5 milionë në fund të Shtatorit dhe do që rritja të nisë nga 1 Janari 2026 (SHKRESA)



Politikë



Politikë

Sali Berisha ndjek emisionin dhe zbulon kush e solli Viora Hysenin në Shqipëri për të drejtuar Shërbimin Informativ

🕒 E Enjte 22:13

Ambasadorja e Izraelit mbyll misionin në Shqipëri, kryeministri Edi Rama e nderon me Yllin e Mirënjohjes Publike (NGJARJA TE VILA E KUQE)

🕒 E Enjte 20:16



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.